

2586
06.10.2025

FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SH.A.

Nr. 5199 Prot.

Tiranë, më 03/10 2025

Lënda: Kërkesë për rivlerësim të të Ardhurave për FSHU dhe çmim të diferencuar të shitjes së energjisë për karikim makinash.

Z. PETRIT AHMETI
Kryetar
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Tiranë

I nderuar, Z. Ahmeti

Ecuria e Performacës Financiare të shoqërisë FSHU për periudhën Janar-Gusht të vitit në vazhdim 2025 është pozitive. Pritshmëria e ecurisë për periudhën në vazhdim Shtator – Dhjetor dhe për vitin 2025 në total, është gjithashtu pozitive në kufijtë e treguesve të parashikuar në Planin Financiar të shoqërisë. Ulja e çmimit të energjisë për konsumatorët familjarë nga 9.5 Lekë/kwh në 8.5 Lekë/kwh, bazuar në vendimin Nr. 10 datë 08.01.2025 nuk ka cënuar performancën e shoqërisë.

Struktura e konsumit të energjisë gjatë periudhës 8-mujore të vitit 2025 ka pësuar ndryshime të rëndësishme në drejtim të rritjes së energjisë së konsumuar për karikimin e baterive të makinave elektrike, përdorimi i të cilave po rritet me shpejtësi. Në mbështetje të rritjes së përdorimit të makinave elektrike FSHU në bashkëpunim me OSSH ka siguruar furnizim të vazhdueshëm të klientëve që konsumojnë energji edhe për karikimin e makinave elektrike.

FSHU analizon ecurinë e treguesve të performancës financiare, ekonomike dhe teknike me qëllim kryerjen e vlersimeve dhe parashikimeve të kostove të saj si dhe të ardhurave që gjenerohen nga struktura aktuale e shitjeve për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV. Këto analiza bëhen të nevojshme nisur nga fakti që në dy vitet e fundit ka rikonceptuar kategorizimin e konsumatorëve të saj me cmime të ndryshme shitje të energjisë pas një periudhe relativisht të gjatë (përmendim këtu krijimin e 3 kategorive të reja të Furra buke/prodhim mielli si dhe krijimin e 2 kategorive të reja të konsumatorëve familjar me cmime të ndryshme bazuar në konsumin mujor të energjisë). Performanca financiare e shoqërisë ka pësuar ndryshime të cilat kanë impaktuar kostot dhe të ardhurat e FSHU si rrjedhojë e ristrukturimit të tregut të energjisë në tërësi, të imponuara mbi të gjitha nga kriza e furnizimit me energji por dhe tipologjive të reja të konsumatorëve. Këto rrethana kanë krijuar nevojën si rrjedhojë dhe të përcaktimit të cmimeve të shitjes së energjisë mbështetur nga impakti i kostove të shkaktuara nga konsumi i energjisë elektrike i kategorive të përkatëse të konsumatorëve fundorë që shërbejnë në kushtet e furnizimit universal.

Gjatë viteve të fundit, një tipologji e re konsumatori ka vijuar të zhvillohet në kohën e futjes në treg të makinave elektrike të cilat funksionojnë 100% me energji elektrike.

Nga analiza e treguesve teknik dhe konsumit specifik të konsumatorëve, në fillimet e instalimit të këtyre pikave/stacioneve të karikimit, konsumi dhe impakti i tyre në kostot e furnizimit nga FSHU sh.a. ka qënë në nivele të papërfillshme. Ndërkohë që nga viti në vit nr i pikave/stacioneve të karikimit ka vijuar të shtohet për arsye të rritjes së nr të makinave elektrike edhe konsumi i tyre ka ardhur në rritje, duke filluar si rrjedhojë krijimin e një tipologjie të re konsumatori.

Nga analiza e treguesve financiar faktik të shoqërisë krahas atyre të planifikuar për vitin 2024 , kosto e blerjes së energjisë dhe kosto transmetimit dhe shpërndarjes ka mbetur e pandryshuar dhe përgjithësisht shpenzimet operative kanë vijuar të jenë konstante. FSHU ka arritur të kryejë nominime edhe më të sakta nisur nga historiku i konsumit sipas kategorive të klientëve duke arritur të ulë koston e disbalancave të shkaktuar nga ndryshimet e energjisë së furnizuar/konsumuar nga ajo e nominuar sipas programeve respektive. Ndërkohë gjatë 8 muhorit të vitit 2025 kosto e disbalancave faktike ka patur një rritje domethënëse. Nga analizat e kryera mbi konsumin e realizuar dhe trendin e tij krahasuar me rritjen e numrit të konsumatorëve për 8 muhorin 2025, edhe pse numri i konsumatorëve nuk ka pësuar një rritje mbi atë të parashikuar, konsumi për kategorit të caktuara të klientëve që furnizohen nga FSHU ka patur një rritje jo konstante krahasur me trendin historik.

Kategoritë të cilat kanë patur rritje të konsumit i përkasin konsumatorëve jofamiljar si vijon:

Industri

Tregti dhe shërbim

Buxhetor

Nisur nga këto rrethana, për nevoja të rekuperimit të kostove të shkaktuara nga pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike, vlersojmë se tashmë ka ardhur momenti i krijimit të një kategorie të re konsumatore si dhe pëcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të karikimit të makinave elektrike duke alokuar kostot e shkaktuara të identifikuara deri më tani mbi kostot konstante dhe të parashikuara sipas trendeve historike të konsumatorëve jo familjar.

Meqënëse në tërësi elementet për llogaritjen e çmimeve të konsumit që furnizohen nga FSHU pritet të mos ndryshojnë, vlersohet se rritja e kostove të disbalancave që krijohet nga karikimi i makinave elektrike dhe do të jetë element i shtuar në përlllogaritjen e çmimit që mbulon kosto për furnizimin e me energji elektrike të konsumatorëve jo familjar që shërbehen prej FSHU të cilët aktualisht paguajnë një cmim prej 14 lekë/kWh.

FSHU kërkon të rekuperojë kostot që priten të shkaktohen në vijim nga kjo kategori konsumatorësh nëpërmjet çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave prej 22 lekë/kWh prej datës 1 Nëntor 2025 e në vijim duke mos ndryshuar cmimet aktuale të shitjes së energjisë elektrike në fuqi për kategoritë ekzistuese të konsumatorëve të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 të cilët furnizohen prej shërbimit universal.

Nga aspekti teknik, furnizimi i makinave elektrike kryhet nëpërmjet pikave/stacioneve të karikimi të cilat kanë fuqi të instaluar në bazë të përdorimit pikave/stacioneve. Konsumatorët familjar apo jo familjar të cilët përdorin tipologji karikuesish slow charge (AC) për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak kërkojnë një shtesë fuqie apo pikë lidhje të re deri në një fuqi prej 11 kW, kjo bazuar edhe në kapacitet aktual të karikimit në AC të makinave elektrike. Ndërkohë që, për pikat/stacionet të cilat karikojnë pa ndërpreje me fast charge (DC) dhe njëkohësisht mbi një makine elektrike kërkojnë një fuqi shumëherë më të madhe.

Bazuar në aplikimet e kryera në OSSH nga abonentë familjarë dhe jo familjarë për shtesë fuqie apo pikë lidhje të re deri në një fuqi 11 kW për qëllime karikimi, propozohet që çmimi prej 22 Lekë/kwh të aplikohet edhe për të gjithë abonentët familjarë dhe jo familjarë me kapacitet të instaluar mbi 11 kW të cilët mund të shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikim mjetesh elektrike. Për abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW do të aplikohen çmimet respektive në fuqi në bazë konsumi..

Të ardhurat shtesë të cilat do të përfitohen nga aplikimi i këtij çmimi parashikohe që nuk do të tejkalojnë vlerën e Të Adhurave të Kërkuara sipas Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë miratuar nga ERE me vendim Nr. 189 datë 23.11.2017 por shërbejnë vetëm për rekuperimin. Në mbështetje të një analize të hollësishme për vlerësimin e kostove në përcaktim të çmimeve të shitjes me pakicë për klientët e Shërbimit Universal, më poshtë gjeni vlersimet tona të treguesve financiar, teknik dhe ekonomik mbi të cilat jemi mbështetur për përllogaritjet e cmimit të propozuar sa më sipër:

1. TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS KRAHASUAR ME TREGUESIT E PLANIFIKUAR PËR PERIUDHËN JANAR-GUSHT 2025

Treguesit kryesorë të performancës për periudhën Janar-Gusht 2025 (i pritshëm) krahasuar me atë të planifikuar sipas planit të vitit 2025 paraqiten në tabelën që vijon:

000/Lekë	Përshkrimi	Viti 2025 Janar-Gusht Fakt	Viti 2025 Janar-Gusht Plan	Diferenca (Fakt-Plan)	%
Të Ardhurat	Të ardhura nga Shitja e energjisë	42,247,043	39,221,556	↑ 3,025,487	107.7%
	Të ardhur nga kamatëvonesat	591,889	680,627	↓ (88,738)	87%
	Të tjera	299,221	299,221	↑ -	100%
	Gjithsej	43,138,153	40,201,404	↑ 2,936,749	107%
Shpenzimet	Shpenzime Energji e Blerë	11,295,689	10,398,907	↓ 896,782	109%
	Tarifa e Shpërndarjes dhe Ener. Reak.	24,030,193	22,572,598	↓ 1,457,595	106%
	Transmetim, Disbalanca dhe Mirmb.	4,296,509	3,939,623	↓ 356,886	109%
	Shpenzime Operative	2,036,721	2,138,610	↑ (101,888)	95%
	Provizione	431,991	431,991	↑ -	100%
	EBITDA	1,047,050	719,676	↑ 327,374	145%
	Amortizimi	108,731	108,731	↑ -	100%
	Shpenzime Financiare	448,888	448,888	↑ -	100%
	Tatim Fitimi	183,349	91,359	↓ 91,990	201%
	Gjithsej	42,832,071	40,130,707	↓ 2,701,364	107%
	REZULTATI FINANCIAR	306,082	70,697	↑ 235,384	
Energji e Shitur		3,839,218	3,593,323	↑ 245,895	↑106.8%

Në tabelë:

➤ **Rezultati Financiar** me një fitim prej rreth 306 milion Lekë për periudhën Janar-Gusht 2025 ishte rreth 235 milion Lekë më i lartë se parashikimet në planin financiar. Faktorët kryesorë të përmirësimit të performancës së shoqërisë në krahasim me atë të planifikuar janë: a) të ardhurat shtesë në muajin Janar prej 442 milion Lekë më shumë se ato të planifikuara për shkak të aplikimit me me 1 shkurt të çmimeve shitjes për klientët familjarë b) rritja e të ardhurave nga shitja e energjisë me rreth 8%, si rezultat i rritjes së konsumit c) ulja e shpenzimeve operative.

Ka një tendencë të uljes së tejkallimit të sasisë së energjisë së shitur e cila ishte rreth 9.4% për periudhën 6 mujore. Në muajin Korrik tejkallimi ishte vetëm 1.4% në krahasim me planin dhe rënie 1.6% në krahasim me të njëjtin muaj të vitit 2024. Ndërsa muaji Gusht shënoi një rënie per 1% në krahasim me planin dhe 3.6% në krahasim me të njëjtin muaj të vitit 2024.

➤ **Sasia e energjisë së shitur** ishte rreth 6.8% (ose 246 Mwh) më shumë se sa ishte parashikuar në planin e vitit 2025. Sasia e energjisë së shitur në tensionin e ulët 0.4 Kv ishte rreth 6.6% (ose 151Mwh) më shumë se plani. Tensioni i mesëm shënoi një rritje prej 13.9% dhe në tensioni 35 Kv ulja ishte 3.9% krahasuar me planin e vitit 2025.

➤ **Të ardhurat nga shitja e energjisë** ishin rreth 3 miliard Lekë më të larta ose 8% se plani i 2025 për shkak të rritjes e konsumit të energjisë.

➤ **Të ardhurat nga kamatëvonesat** ishin 89 milion Lekë më të ulta duke i krahasuar me planin e miratuar të vitit 2025.

➤ **Shpenzimet për blerjen e energjisë** ishin 897 milion Lekë më të larta rreth 9% krahasuar me planin e 2025 për shkak të rritjes së konsumit të energjisë së shitur me 6.8% më shumë se ajo e planifikuara për periudhën Janar-Gusht 2025 dhe ndryshimeve strukturore.

➤ **Shpenzimet për Tarifën e Shpërndarjes dhe Energji Reaktive** u rritën në 1.5 miliard Lekë ose me rreth 6.5% duke e krahasuar me planin e vitit 2025.

➤ *Shpenzimet për Tarifën e Transmetimit dhe Disbalancat* u rritën në 356 milion Lekë ose me rreth 9% në krahasim me ato të planifikuarën e vitit 2025.

➤ *Shpenzimet Operative* janë rreth 102 milion Lekë ose rreth 5% më të ulta se planifikimi për vitin 2025.

Në vijim paraqesim Pasqyrën e Performancë analitike të realizuar për periudhën Janar- Gusht 2025 krahas planit të FSHU sh.a. për këtë periudhë:

FSHU PASH (000 / ALL)	Janar - Gusht 2025	Janar - Gusht 2025	GUSHT	
	FSHU	Plani FSHU	Diferencë	%
TË ARDHURA				
Të adhura nga SHITJA	43,138,153	40,201,404	2,936,749	107%
Të Ardhura të Tjera	42,838,932	39,902,183	2,936,749	107.4%
	299,221	299,221	-	100%
SHPENZIMET				
Shpenzime Energjie	(42,199,834)	(39,590,460)	(2,609,374)	107%
<i>Energji e Blerë</i>	(39,622,391)	(36,911,128)	(2,711,263)	107%
Blerë në Tregun e Lirë	(11,295,689)	(10,398,907)	(896,782)	109%
Blerje nga KESH	(14,113)	-	(14,113)	
Për Tariforët (0.4Kv)	(11,281,576)	(10,398,907)	(882,669)	108%
Për FMF (35/20/10/6Kv)	(8,242,140)	(7,752,309)	(489,831)	106%
Për Ujësjetlla (35/20/10/6Kv)	(2,363,710)	(1,997,116)	(366,594)	118%
Tarifa e Shpërndarjes	(675,726)	(649,483)	(26,244)	104%
Energji Reaktive	(23,825,462)	(22,355,340)	(1,470,122)	106.6%
Tarifa e Transmetimit	(204,731)	(217,258)	12,527	94%
Disbalancat	(3,263,335)	(3,054,325)	(209,010)	107%
Tarifë e mirëmbajtjes "0/kwh" FSHU	(552,045)	(430,583)	(121,462)	128%
Marzhi Bruto	(481,129)	(454,716)	(26,413)	106%
Marzhi Bruto %	2,624,652	2,310,428	314,224	114%
Shpenzime Operative	6.2%	5.9%	0.3%	105%
	(2,036,721)	(2,138,610)	101,888	95%
Dëmtime dhe Provigjone	(431,991)	(431,991)	-	100%
EBITDA	(431,991)	719,676	327,374	145%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	1,047,050	(108,731)	-	100%
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	(108,731)	610,944	327,374	154%
Shpenzime Financiare - neto	938,319	(448,888)	-	100%
Fitim / Humbja përpara Taksave	(448,888)	162,056	327,374	302%
Shpenzime Tatim Fitimi	489,430	(91,359)	(91,990)	201%
Fitim / Humbja e Periudhës	(183,349)	70,697	255,384	433%
	306,082			

Sikurse vërehet në tabelën në vijim, realizimi faktik i të ardhurave dhe shpenzimeve ka diferenca të theksuara sa i takon planifikimi të FSHU sh.a.. Sikurse sqaruar dhe më sipër, kosto e blerjes së energjisë, transmetimit dhe shpërndarjes janë kosto të pa ndryshueshme për arsye se cmimi i blerjes së energjisë, tarifa e transmetimit dhe shpërndarjes janë tarifa statike dhe ndryshimet në vlerë të shpenzimeve për këta komponentë të të ardhurave të kërkuara rriten në proporcion të drejtë me rritjen e konsumit. Këto kosto mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga shitja të cilat duke aplikuar cmimet e shitjes në fuqi për kategoritë e klientëve të cilët furnizohen në kushtet e shërbimit universal dhe kushte e mundësisë së fundit. Të vetmet kosto variabël të shoqërisë janë:

- Kosto e blerjes së energjisë për klientët të cilët furnizohen nga FMF në nivelin e tensionit 35 kV meqënëse energjia për mbulimin e konsumit të tyre prokurohet në tregun e lirë (ALPEX) sipas cmimeve ditore/orare të cilat ndryshojnë në varësi të kërkesës dhe ofertës për energji elektrike, kosto e cila nuk ka efekte të qënësishme në performancën financiare të FSHU sh.a.
- Kosto e disbalancave të cilat impaktohen nga diferencat e programeve mujore, javore dhe ditore për mbulimin e kërkesës me energji elektrike për klientët universalë, dhe energjisë faktike të furnizuar nga FSHU sh.a. vlerë e cila ka impakt në performancën financiare të shoqërisë sidomos kur planifikimi dhe fakti kanë diferenca të theksuara.

Nga analiza e tregusve të performancës, është evidentuar se kosto e realizuar e disbalancës krahasuar planifikimit të shoqërisë ka patur një trend në rritje.

Nisur nga informacionet e vëna në dispozicion nga OSSH sh.a., këto kategori konsumatorësh nuk kanë regjistruar kontrata të reja furnizimi por nga ana tjetër është vërejtur se kanë patur një rritje të numrit të pikave të reja të lidhjes me rrjetin e shpërndarjes për furnizimin me energji elektrike duke i regjistrua ato brenda të njëjtës kontratë furnizimi. Kërkesat për lidhje të reja sipas këtyre specifikave i përkasin përgjithësisht pikave/stacioneve të karikimit të makinave elektrike dhe këto kategori klientësh i kanë regjistruar në kontratat e furnizimit të shoqërive që ushtrojnë aktivitet tregtar apo klientëve që i përkasin kategorisë buxhetor.

Përgjithësisht rritja e kostonë së disbalancave për periudhën 8 mujore 2025 ka ardhur nga disa faktorë duke përfshirë edhe rritjen e konsumit të energjisë nga pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike, dhe meqënëse ky fenomen vijon të jetë në rritje, bëhet e nevojshme që këto kosto të recuperohen nëpërmjet duke alokuar këtë shpenzim për njësi konsumi të furnizuar me qëllim mbulimin e kërkesës për energji për pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike, ku numri i makinave të regjistruara sipas publikimeve zyrtare të DPSHRT vijon të ketë një rritje galopante nga viti në vit dhe pritet të jetë e tillë dhe në periudhën në vazhdim.

Në vlersimet e kryera duke mos patur një historik konstat të konsumit të kësaj kategorie nuk mund të realizohen programe për mbulimin e kërkesës për energji të përafërta me konsumin faktik duke qënë se konsumi në pikat/stacionet e karikimit është gjithmonë në rritje të vazhdueshme prej rritjes së pikave/stacioneve të karkimit prej rritjes së numrit të makinave elektrike.

2. VLERËSIM I SHITESËS SË TË ARDHURAVE LIDHUR ME KONSUMIN E ENERGJISË PËR KARIKIMIN E MAKINAVE.

Të dhënat nga OSSH për konsumin e energjisë për karikimin e makinave elektrike për periudhën Janar – Gusht 2025 shërbyen si bazë për llogaritjen e shtesës së të ardhurave të shoqërive të OSHEE Grup (përfshi furnizimin në FSHU dhe FMF):

- Të dhëna lidhur me Numrin e konsumatorëve paraqiten në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	Njësia	SUBJEKT E PRIVAT	TAXI	BUXHET ORE	TE TJERE	TOTALI
Furnizuesi						
Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)	Nr.kon	55	99	19	46	219
Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF)	"	6	-	1	13	20
Furnizuesi i Tregut të Lire (FTL)	"	11	2	1	1	15
Totali	"	72	101	21	60	254

- Të dhëna për sasitë e energjisë së konsumuar për periudhën 8-mujore dhe parashikim vjetor 2025 paraqiten në tabelën më poshtë:

LLOJI I PIKES SE KARIKIMIT	8 - MUJORI 2025 Kwh	MESATARJA MUJORE Kwh	PARASHIKIMI VJETOR 2025 Kwh
TAXI	9,164,862	1,145,608	13,747,293
Shërbim karikimi për palë të treta	1,986,998	248,375	2,980,497
Përdorim Personal	1,785,321	223,165	2,677,982
BUXHETORE	701,871	87,734	1,052,807
Grand Total	13,639,052	1,704,882	20,458,578

Përshkrimi	8 - MUJORI 2025 lekë	MESATARJA MUJORE lekë	PARASHIKIMI VJETOR 2025 lekë
Kosto e disbalancave e realizuar mbi target	109,112,416	13,639,052	163,668,624

Për vitin 2025

2025

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
FSHU	kWh	2,980,497	13,747,293	1,052,807	2,677,982	20,458,578
Lekë	kWh	14.00	14.00	14.00	14.00	14.00
Te ardhura nga çmimi aktual FSHU	Lekë	41,726,958	192,462,102	14,739,291	37,491,741	286,420,092

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
FSHU	kWh	2,980,497	13,747,293	1,052,807	2,677,982	20,458,578
Lekë	kWh	22.00	22.00	22.00	22.00	22.00
Te ardhura nga çmimin e ndryshuar FSHU	Lekë	65,570,934	302,440,446	23,161,743	58,915,593	450,088,716

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
------------	--------	------------------	------	--------	----------	--------

Diference ne te ardhurat e FSHU	Lekë	23,843,976	109,978,344	8,422,452	21,423,852	163,668,624
---------------------------------	------	------------	-------------	-----------	------------	-------------

Për lehtësi krahasimi të ardhurat për vitin 2025 u supozuan që nga fillimi i vitit pavarësisht periudhës së zbatimit të çmimit të ndryshuar dhe po kështu edhe shpenzimet.

Për vitin 2026

Sasia e energjisë së shitur është supozuar të rritet me 50% mbështetur nga nr. i makinave të regjistruara gjatë vitit 2025 ndaj nr. të makinave të regjistruara gjat vitit 2024 mbështetur në të dhënat e publikuar në raportet e DPSHTRr :

VITI 2026

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
FSHU	kWh	4,470,746	20,620,940	1,579,210	4,016,972	30,687,867
Lekë	kWh	14.00	14.00	14.00	14.00	14.00
Te ardhura nga çmimi aktual FSHU	Lekë	62,590,437	288,693,153	22,108,937	56,237,612	429,630,138

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
FSHU	kWh	4,470,746	20,620,940	1,579,210	4,016,972	30,687,867
Lekë	kWh	22.00	22.00	22.00	22.00	22.00
Te ardhura nga çmimin e ndryshuar FSHU	Lekë	98,356,401	453,660,669	34,742,615	88,373,390	675,133,074

Pershkrimi	Njesia	Subjekte private	Taxi	Buxhet	Te tjere	Totali
Diference ne te ardhurat e FSHU	Lekë	35,765,964	164,967,516	12,633,678	32,135,778	245,502,936

Nëse çmimi i shitjes së energjisë për karikimin e makinave për këta klientë do të rritej në 22 Lekë/kwh për vitin 2026 shoqëria FSHU do të përfitonte një shtesë neto në të ardhurat prej rreth **245,502 mijë Lekë** të cilat parashikohet të rekuperojnë kostot e pritshme që pritet të shkaktojë kjo kategori konsumatore.

3. VLERËSIMI SHITESËS SË TË KOSTOVE TË DISBALANCEVE LIDHUR ME KONSUMIN E ENERGJISË PËR KARIKIMIN E MAKINAVE.

Për tu theksuar se aktiviteti i karikimit të makinave elektrike është një aktivitet i ri parashikimet e treguesve të të cilit nuk mbështeten mbi të dhëna historike. Zhvillimi i vrullshëm i tij krijon një shkallë të lartë pasigurie në planifikimin dhe vlerësimet dhe llogaritjet në këtë dokument përfaqsojnë njohurinë më të mirë të hartuesve të tij, pa pretenduar realizimin në shkallë të lartë të probabiliteti.

Shërbimi i furnizimit për karikim të makinave rrit në koston e dibalancave për shkaqe që lidhen me teknologjinë e karikimit:

- Koha e karikimit varet nga kapaciteti i baterisë dhe vlera e ulët e fuqisë së saj në periudhën e vendosjes në karikim, prandaj edhe koha e qëndrimit dhe sasia e energjisë që do të përdoret është vështirë të parashikohet duke rritur disbalancat.
- Përdorimi i kapacitetit të instaluar është i lartë në periudhën e parë të karikimit me fuqi dhe konsum të madh energjie dhe i ulët në pjesën e fundit të saj duke ulur probabilitetin e saktësisë së parashikimit që ndikon në rritjen e disbalancave.
- Parashikimet e energjisë së haxhuar vështirësohen më tej në rastet e pikave të karikimit me më shumë se një automjet duke rritur më tej kostot e disbalancave.

Nga aktiviteti i karikimit të makinave për këta klientë do të rritej në 22 Lekë/kwh për vitin 2026 shoqëria FSHU do të përfitonte një shtesë neto në të ardhurat prej rreth **245,502 mijë Lekë**.

Nga vlerësimet Të Ardhurat Sipas Strukturës së Çmimeve për vitin 2026 janë të njëjta me llogaritjet për Të Ardhurën e Kërkuar dhe po kështu edhe për pjesën e mbetur të vitit 2025

Nga sa më sipër mendojmë se aplikimi i Çmimit të Diferencuar për energji të konsumuar për karikim makinash nuk do të ketë efekt në Performancën Financiare të FSHU për vitin 2026, e cila do të mbetet pozitive dhe me një fitim minimal.

Duke patur parasysh zhvillimin e vullshëm të këtij aktiviteti në tregun e energjisë, i cili është pjesë e zhvillimeve prioritare sipas Programit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe nevojën e ngutëshme të mbulimit të kostove që krijohen për aktivitetin e FSHU, kërkojmë shqyrtimin e përshpejtuar të kësaj kërkesë e cila besoj se do të gjejë edhe mirëkuptimin tuaj.

Të gatshëm për të bashkëpunuar me ju për analizën e detajur të kostove në përcaktimin e Çmimit Mesatar të Shitjes me Pakicë për Klientët e Shërbimit Universal.

Me konsideratë,

ADMINISTRATORI
ALBERT LUZI

